



Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2021



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	5
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	6
Shënimet e pasqyrave financiare.....	7-14

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Kosova Demokrat Turk Partisi

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “KDTP”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2021, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin që përfundon me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 6-14.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve për çështjet e përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2021, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që përfundon me këtë date, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për opinionin të kualifikuar

- Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar qe Subjekti Politik për shpenzimet e qirasë ne vlere 14,820 Euro nuk ka ndal tatimin ne burim ne qira, sipas kërkesave ligjore qe burojnë nga Lgji NR:05/L-028 për tatimin e mbajtur ne burim , neni-39. Po ashtu subjekti politik ka nënvlerësuar shpenzimet e qirasë për vitin 2021 vlerën 1,350.00 euro.
- Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar qe subjekti politikë ka mbivlerësuar te hyrat dhe shpenzimet për vlerën 5,582.98 nga kontributet ne natyre mallra dhe shërbime për vitin qe përfundon me 31 dhjetor 2021, kontribute këto te dhëna për asete fikse.
- Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar qe subjekti politikë ka nënvlerësuar te hyrat dhe shpenzimet nga kontributet ne natyre mallra dhe shërbime ne vlere 580.10 euro për vitin qe përfundon me 31 dhjetor 2021.
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 2 Shpenzimet, subjekti politik ka deklaruar shpenzime për vitin 2021 vlerën 97,262.19 EURO. Gjithsesi, gjate auditimit ton ne kemi konstatuar për vlerën e shpenzimeve 5,890.66 EURO subjekti politik nuk ka liste detale te shpenzimeve te regjistruara

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej ne paragrafin “Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”. Ne jemi të pavarur nga Subjekti Politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të

zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazë për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tej opinionin ton ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e drejtuesve dhe e atyre të ngarkuar me udhëheqjen e SP për Pasqyrat Financiare

Drejtuesit e Subjektit politik janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse drejtimi synon të likujdojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP-së.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit

që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit&Conto sh.p.k

Elmije Osmani Shatri

Auditore Ligjore

18 Tetor 2023

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2021	Me 31 Dhjetor 2020
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	9,374.58	6,927.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		9,374.58	6,927.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	166.79	6,241.10
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		166.79	6,241.10
Total pasuritë		9,541.37	13,168.10
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		3,541.93	4,534.37
Suficiti / (deficiti) i vitit		(8,191.19)	(992.44)
Total Ekuiteti		(4,649.26)	3,541.93
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	5	9,374.58	6,927.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		9,374.58	6,927.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8		
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	4,816.05	2,699.17
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		4,816.05	2,699.17
Gjithsej detyrimet		14,190.63	9,626.17
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		9,541.37	13,168.10

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2021	2020
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		64,748.42	63,000.00
Të hyrat nga anëtarësia		105.00	1,476.20
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	2,500.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	6,782.58	
Të hyrat e fushatës		11,800.00	
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyra	5	3,135.00	3,135.00
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		89,071.00	67,611.20
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	26,268.48	32,637.94
Shpenzimet e transportit	2	3,233.30	4,327.77
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	1,026.15	2,309.84
Shpenzimet e fushatës	2	41,476.69	0.00
Blerja e mallrave	2	0.00	2,039.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	25,257.57	19,470.39
Shpenzimet e ndryshme	2	0.00	7,818.70
Gjithsej shpenzimet për vitin		97,262.19	68,603.64
Suficiti / (deficiti) për vitin		(8,191.19)	(992.44)

1. Informata te përgjithshme

Kosova Demokratik Turk Partesi KDTP

E themeluar: 2001

Kryetar : Fikrim Damka

Zyrtar financiar: Sezer Hoti

Adresa: Prizren

Pasqyrat financiare te KDTP-së janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën: NLB.

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	23,714.00	23,544.00	170.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	900.32	680.96	219.36
Kontributet pensionale të punëdhënësit	900.32	680.96	219.36
Tatimet në të ardhura personale	753.84	561.23	192.61
Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej	26,268.48	25,467.15	801.33
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	1,897.94	1,897.94	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	585.00	585.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	750.36	750.36	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	3,233.30	3,233.30	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			
Ushqimi	1,026.15	554.15	472.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	1,026.15	554.15	472.00
Shpenzimet e fushatës			

Shpenzimet e fushatës	41,476.69	41,476.69	0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	41,476.69	41,476.69	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës			0.00
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	12,623.97	9,948.97	2,675.00
Telefoni, interneti dhe posta	564.86	564.86	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	2,151.16	1,283.44	867.72
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	3,135.00	////	////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	6,782.58	////	////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	25,257.57	11,797.27	3,542.72
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet	97,262.19	82,528.56	4,816.05

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat	24,500.00		19,150.00	2,450.00	2,900.00
Pajisjet e zyrës	5,318.00	5,582.58	3,957.00	532.00	6,411.58
Pajisjet e teknologjisë informative	1,532.00		1,316.00	153.00	63.00
Pajisjet tjera					0.00
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	31,350.00	5,582.58	24,423.00	3,135.00	9,374.58

Shenime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro
Llogari te arketueshme		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	////////	//////////

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro
Paraja në bankë	166.79	5,391.70
Paraja në arkë		849.40
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	166.79	6,241.10

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro
Furnitor vendor		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	////////////////////	////////////////////

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	801.33	304.17
Detyrimet për qira	2,675.00	2,395.00
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	1,339.72	
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	4,816.05	2,699.17

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguat ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					////////////////////